

**CULTURAL EXCHANGES, PROPERTY, AND COOPERATION**

**Import Restrictions**

**Memorandum of Understanding Between the  
UNITED STATES OF AMERICA  
and ALBANIA**

Signed at Washington August 23, 2021

Entered into force February 28, 2022



NOTE BY THE DEPARTMENT OF STATE

Pursuant to Public Law 89—497, approved July 8, 1966  
(80 Stat. 271; 1 U.S.C. 113)—

“ . . .the Treaties and Other International Acts Series issued under the authority of the Secretary of State shall be competent evidence . . . of the treaties, international agreements other than treaties, and proclamations by the President of such treaties and international agreements other than treaties, as the case may be, therein contained, in all the courts of law and equity and of maritime jurisdiction, and in all the tribunals and public offices of the United States, and of the several States, without any further proof or authentication thereof.”

MEMORANDUM OF UNDERSTANDING  
BETWEEN  
THE UNITED STATES OF AMERICA  
AND  
THE REPUBLIC OF ALBANIA  
CONCERNING THE IMPOSITION OF IMPORT RESTRICTIONS  
ON CATEGORIES OF ARCHAEOLOGICAL AND ETHNOLOGICAL MATERIAL  
OF ALBANIA

The United States of America and the Republic of Albania, hereafter referred to as "Parties";

Acting pursuant to the 1970 UNESCO Convention on the Means of Prohibiting and Preventing the Illicit Import, Export and Transfer of Ownership of Cultural Property, to which both countries are States party; and

Desiring to reduce the incentive for pillage of irreplaceable archaeological and ethnological material representing Albania's cultural heritage,

Have agreed as follows:

ARTICLE I

1. The United States of America shall, in accordance with its legislation, including the Convention on Cultural Property Implementation Act, restrict the importation into the United States of certain categories of archaeological material ranging in date from 300,000 years ago to A.D. 1750 and certain categories of ethnological material ranging in date from c. A.D. 400 to 1913, which may include categories of architectural elements from historic or religious structures; funerary objects; ritual and ceremonial objects; paintings; written records; textiles; and weapons and armor, identified in the list to be promulgated by the United States of America (hereinafter referred to as the Designated List), unless the Republic of Albania issues a certification that such exportation was not in violation of its laws.
2. The United States of America shall offer for return to the Republic of Albania any object or material on the Designated List forfeited to the United States of America.

3. Such import restrictions shall become effective on the date the Designated List is published in the U.S. Federal Register, the official United States Government publication providing fair public notice.

## ARTICLE II

1. Both Parties shall publicize this Memorandum of Understanding (MOU) and the reasons for it, in accordance with legislation in force in each country.
2. The Republic of Albania shall use its best efforts to maintain and share with the United States of America information about unauthorized excavations, thefts of cultural property, trafficking of cultural property, and other threats that jeopardize its cultural patrimony.
3. The Republic of Albania shall continue to use its best efforts to take steps consistent with the 1970 UNESCO Convention on the Means of Prohibiting and Preventing the Illicit Import, Export and Transfer of Ownership of Cultural Property to protect its cultural patrimony. To assist in these efforts, the United States of America shall use its best efforts to facilitate technical assistance to the Republic of Albania as appropriate under available programs in the public and/or private sectors.
4. The Republic of Albania shall continue to use its best efforts to engage other countries having a significant import trade in archaeological and ethnological materials from Albania to deter a serious situation of pillage of cultural property.
5. Each Party shall use best efforts to encourage interchange of archaeological and ethnological materials for cultural, educational, and scientific purposes, including long-term loans of such materials to promote widespread public appreciation of and opportunity to access to Albania's rich cultural heritage.
6. Each Party shall continue to endeavor to keep the other informed of the measures taken to implement this MOU.

## ARTICLE III

The obligations of both Parties and the activities carried out under this MOU shall be subject to their respective laws and regulations, including those with respect to the availability of funds.

## ARTICLE IV


1. This MOU shall enter into force on the date of the later note in an exchange of notes in which the Parties have notified each other of the completion of the internal procedures necessary for that purpose. This MOU shall remain in force for a period of five (5) years, unless extended.

2. This MOU may be extended and amended only by mutual written consent of the Parties.
3. The Parties shall review the effectiveness of this MOU before the expiration of the five (5)-year period in order to determine whether the MOU should be extended.
4. Either Party may notify the other, in writing through diplomatic channels, of its intention to terminate this MOU prior to its date of expiry. In such a case the termination shall come into effect six (6) months after the date of notification.

In witness whereof, the undersigned, being duly authorized by their respective Governments, have signed the present MOU.

Done at Washington, on August 23, 2021, in duplicate, in the English and Albanian languages, both texts being equally authentic.

FOR THE UNITED STATES OF  
AMERICA:



FOR THE REPUBLIC OF ALBANIA:



MEMORANDUM MIRËKUPIMI  
NDËRMJET  
SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS  
DHE  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
LIDHUR ME VENDOSJEN E KUFIZIMEVE TË IMPORTIT  
PËR KATEGORITË E MATERIALEVE ARKEOLOGJIKE DHE ETNOLOGJIKE TË  
SHQIPËRISË

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Republika e Shqipërisë, këtu e më poshtë të përmendura si "Palët",

Duke vepruar në përputhje me Konventën e UNESCO-s e vitit 1970 për Mjetet e Ndalimit dhe të Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurisë Kulturore, ku të dyja vendet janë Shtete palë; dhe

Duke dëshiruar të zvogëlojnë shtysën për plaçkitjen e materialit të pazëvendësueshëm arkeologjik dhe etnologjik që përfaqëson trashëgiminë kulturore të Shqipërisë,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

NENI I

1. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në përputhje me legjislacionin e tyre, përfshirë edhe Aktin për Zbatimin e Konventës për Pasurinë Kulturore, do të kufizojnë importimin në Shtetet e Bashkuara të kategorive të caktuara të materialit arkeologjik, që datojnë nga 300,000 vite më parë deri në vitin 1750 P.K. dhe kategori të caktuara të materialit etnologjik, që datojnë përparësisht nga viti 400 P. K. deri në vitin 1913, të cilat mund të përfshijnë kategori të elementeve arkitekturore nga strukturat historike ose fetare; objekte funerale; objekte rituale dhe ceremoniale; piktura; dokumente të shkruara; tekstile; si edhe armë e parzmore të identifikuar në listën që do të shpallet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (këtu e më poshtë e referuar si Lista e Përcaktuar), përveç rasteve kur Republika e Shqipërisë lëshon një vërtetim, ku vërtetohet se ky eksportim nuk është bërë në kundërshtim me ligjet e vendit.
2. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t'i ofrojnë Republikës së Shqipërisë kthimin e çdo objekti ose materiali në Listën e Përcaktuar të konfiskuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

3. Kufizime të tilla të importit do të hyjnë në fuqi në datën kur Lista e Përcaktuar botohet në Regjistrin Federal të SHBA-së, Fletorja zyrtare e qeverisë së Shteteve të Bashkuara që ofron njoftim të paanshëm të publikut.

## NENI II

1. Të dy Palët do ta publikojnë këtë Memorandum Mirëkuptimi (MM) dhe arsyet e lidhjes së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi të secilit vend.
2. Republika e Shqipërisë do të bëjë përpjekjet e saj më të mira për të ruajtur dhe ndarë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës informacione rreth gërmimeve të paautorizuara, vjedhjeve të pasurive kulturore, trafikimit të pasurive kulturore dhe kërcënimeve të tjera që rrezikojnë trashëgiminë e saj kulturore.
3. Republika e Shqipërisë do të vazhdojë të përdorë përpjekjet e saj më të mira për të ndërmarrë hapa në përputhje me Konventën e UNESCO-s të vitit 1970 për Mjetet e Ndalimit dhe të Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurisë Kulturore, me qëllim që të mbrojë trashëgiminë e saj kulturore. Në ndihmë të këtyre përpjekjeve, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përdorin përpjekjet e tyre më të mira për të lehtësuar ndihmën teknike ndaj Republikës së Shqipërisë, sipas nevojës, në bazë të programeve në dispozicion në sektorët publik dhe/ose privat.
4. Republika e Shqipërisë do të vazhdojë të përdorë përpjekjet e saj më të mira për të angazhuar vendet e tjera, të cilat kanë një tregti të konsiderueshme të importimit të materialeve arkeologjike dhe etnologjike nga Shqipëria, me qëllim që të parandalojë një situatë të rëndë të plaçkitjes së pasurisë kulturore.
5. Secila Palë do të përdorë përpjekjet e saj më të mira për të inkurajuar shkëmbimin e materialeve arkeologjike dhe etnologjike për qëllime kulturore, arsimore dhe shkencore, përfshirë edhe dhënien hua të këtyre materialeve për një afat kohe të gjatë, me qëllim që të nxitet vlerësimi i publikut të gjerë dhe mundësitë e qasjes ndaj trashëgimisë së pasur kulturore të Shqipërisë.
6. Secila palë do të vazhdojë të përpiqet që të mbajë palën tjetër të informuar mbi masat e marra për zbatim e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

## NENI III

Detyrimet e të dy Palëve dhe veprimtaritë e kryera në zbatim të këtij Memorandumi u nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve të tyre përkatëse, përfshirë ato në lidhje me disponueshmërinë e fondeve.


#### NENI IV

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit më të fundit të shkëmbimeve të njoftimeve ku Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për këtë qëllim. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të mbetet në fuqi për një periudhë prej pesë (5) vitesh, përveç se nëse zgjatet.
2. Ky Memorandum mund të zgjatet dhe ndryshohet vetëm me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve.
3. Palët do të rishikojnë efektshmërinë e këtij Memorandumi Mirëkuptimi para skadimit të periudhës pesë (5) vjeçare, me qëllim që të përcaktojnë nëse Memorandumi i Mirëkuptimit duhet të zgjatet.
4. Secila Palë mund të njoftojë tjetrën, me shkrim, përmes kanaleve diplomatike, për qëllimin e saj që të përfundojë këtë Memorandum Mirëkuptimi para datës së mbarimit. Në një rast të tillë, përfundimi hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas datës së njoftimit.

Në prani të tyre, secili prej të nënshkruarve, të autorizuar përkatësisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Lidhur në Uashington, më 23 gusht 2021, në dy kopje, në gjuhën angleze dhe shqipe, të dy tekstet janë njësoj autentike.

PËR SHTETET E BASHKUARA TË  
AMËRIKËS:



PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË:

